



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 11

Tiranë – E mërkurë, 3 shkurt 2016

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 49, datë 27.1.2016	Për miratimin e dokumentit ndryshues të marrëveshjes së grantit nr. TF013972, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim që vepron si administratore e fondeve grant, të siguruara nga dhurues të ndryshëm, nën fondin e dytë të besimit shumëdhurues për Shqipërinë, për mbështetjen për ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e sistemit të planifikimit të integruar.....	573
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 51, datë 27.1.2016	Për një ndryshim në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar.....	575
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 53, datë 27.1.2016	Për një ndryshim në vendimin nr. 737, datë 9.9.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave të akreditimit dhe për trajnimet e organizuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit”...	575
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 27.1.2016	Për lirim dhe emërim në detyrë.....	576
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 55, datë 27.1.2016	Për miratimin e paraqitjes, formës dhe specifikimeve teknike të gradave, simboleve, uniformave dhe shenjave të Policisë së Shtetit.....	576
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 56, datë 27.1.2016	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Punëve të Brendshme, për marrjen e masave parandaluese, si pasojë e situatës emergjente të krijuar nga rrëshqitja e tokës, në njësinë administrative Farkë, Bashkia Tiranë.....	632
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 58, datë 27.1.2016	Për kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Gramsh, të pronës nr. 334, me emërtim “Ish-reparti ushtarak nr. 9920, Grup Depo”, me vendndodhje “Përroi i Çekrezit”, Gramsh, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar.....	632

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 59, datë 27.1.2016	Për miratimin e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike për vitin 2016.....	634
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 60, datë 27.1.2016	Për disa ndryshime në vendimin nr. 149, datë 29.2.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave për punonjësit e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare”, të ndryshuar	635
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 62, datë 27.1.2016	Për miratimin e zbatimit të procedurës së thjeshtuar për ndryshimin e Planit Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik (Projekti TAP), të miratuar me vendimin nr. 1, datë 4.7.2013, të Këshillit Kombëtar të territorit, “Për miratimin e Planit Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik (Projekti TAP)”.....	637
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 63, datë 27.1.2016	Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.....	638
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 64, datë 27.1.2016	Për programin e nxitjes së punësimit të të rinjve që kanë fituar statusin e jetimit.....	647

**VENDIM****Nr. 49, datë 27.1.2016**

**PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT
NDRYSHUES TË MARRËVESHJES SË
GRANTIT NR. TF013972, NDËRMJET
SHQIPËRISË DHE BANKËS
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM/SHOQATËS
NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM QË
VEPRON SI ADMINISTRATORE E
FONDEVE GRANT, TË SIGURUARA
NGA DHURUES TË NDRYSHËM, NËN
FONDIN E DYTË TË BESIMIT
SHUMËDHURUES PËR SHQIPËRINË,
PËR MBËSHTETJEN PËR NGRITJEN E
KAPACITETEVE PËR ZBATIMIN E
SISTEMIT TË PLANIFIKIMIT TË
INTEGRUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e dokumentit ndryshues të marrëveshjes së grantit nr. TF013972, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve grant të siguruara nga dhurues të ndryshëm, nën fondin e dytë të besimit shumëdhurues për Shqipërinë, për mbështetjen për ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e sistemit të planifikimit të integruar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

Banka Botërore
Banka Ndërkombëtare për
Rindërtim dhe Zhvillim
Shoqata Ndërkombëtare për
Zhvillim

1818 H Street N.W.
Washington, D.C.
20433
U.S.A.

(202) 477-1234
Adresa Kabllore:
INTBAFRAD
Adresa Kabllore:
INDEVAS

[Datë]

SH. e tij Shkëlqim Cani
Ministri i Financave
Ministria e Financave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Tiranë, Shqipëri

**Lënda: Mbështetje për Ndërtimin e
Kapaciteteve në Shqipëri për Zbatimin e
Sistemit të Planifikimit të Integruar (IPS) 2
Granti nr. TF013972
Amendimi nr. 1 i Marrëveshjes së Grantit**

Shkëlqesi,

I referohemi marrëveshjes së grantit të datës 7 mars 2013 (Marrëveshja) ndërmjet Shqipërisë (Marrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (Banka Botërore) për grantin e lartpërmendur (Granti).

Kemi kënaqësinë të pranojmë, në emër të Bankës Botërore, qëllimin e Bashkimit Evropian (Donatori) për akordimin e një kontributi për Grantin në shumën e një milion e njëqind mijë eurove (€ 1,100,000) (Kontributi). Duke marrë parasysh të ardhurat e investimit të fituara dhe luhatjen e kursit të këmbimit valutor që nga koha e Kontributit, shuma e Kontributit në fakt do të jetë një milion e njëqind mijë e tetëqind e dhjetë euro (€ 1.100.810).

Duke pasur parasysh sa më sipër dhe diskutimet tona të fundit, Banka Botërore propozon ndryshimin e Marrëveshjes, për: a) rritjen e shumës së Grantit me një shtesë prej një milion e njëqind mijë e tetëqind e dhjetë eurosh (€ 1.100.810); b) përditësimin e përshkrimit të projektit; dhe c) përditësimin e përkufizimeve të disa kategorive të shpenzimeve.

Si rrjedhojë, Marrëveshja ndryshohet si më poshtë:

1. Paragrafi 1 i Marrëveshjes ndryshohet në këtë mënyrë dhe zëvendësohet në tërësi me formulimin e mëposhtëm:

“Në përgjigje të kërkesës për mbështetje financiare të bërë në emër të Republikës së Shqipërisë (Marrësi), kam kënaqësinë t’ju informoj se Banka Ndërkombëtare për Rindërtim

dhe Zhvillim/Shoqata Ndër-kombëtare për Zhvillim (Banka Botërore), duke vepruar si administratore e fondeve të grantit, të dhëna nga donatorë të ndryshëm (“Donatorët” që nënkuptojnë Agjencinë Austriake për Zhvillim, Agjencinë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe Bashkimin Evropian), sipas Fondit të Posaçëm me Shumë Donatorë, të dytë për Shqipërinë, për mbështetje në ndërtimin e kapaciteteve për zbatimin e Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) (TF071824), propozon akordimin për Marrësin të një granti në shumën që nuk tejkalon tre milionë e tetëqind e pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e shtatë euro (€ 3.815.107) (Granti) sipas termave dhe kushteve të përcaktuar apo të referuar në këtë marrëveshje (Marrëveshja), e cila përfshin Aneksin bashkëlidhur, për të ndihmuar në financimin e projektit të përshkruar në aneks (Projekti).

2. Paragrafi 1.02 i Marrëveshjes ndryshohet në këtë mënyrë dhe zëvendësohet në tërësi me formulimin e mëposhtëm:

“1.02. Përkufizime. Përveç rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe, termat me germa kapitale të përdorur në këtë Marrëveshje kanë kuptimet që u jepen atyre në kushtet standarde ose në këtë Marrëveshje.

“CFCU” nënkupton Njësia Qendrore e Financimeve dhe Kontraktimeve.

“PFM” nënkupton menaxhimin e financave publike.

“PEFA” nënkupton shpenzimet publike dhe vlerësimin financiar.

“PDO” nënkupton objektivin e zhvillimit të projektit.

“IPS” nënkupton sistemin e planifikimit të integruar.

“AFMIS” nënkupton sistemin informativ të menaxhimit financiar shqiptar.”.

3. Pjesa e tretë e paragrafit 2.01 të Marrëveshjes ndryshohet në këtë mënyrë dhe zëvendësohet në tërësi me formulimin e mëposhtëm:

“Pjesa e tretë:

Zhvillimi i Sistemeve IPS të Menaxhimit të Informacionit: ky komponent do të financojë përgatitjen e një Strategjie për Modernizimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Zhvillimin e AFMIS-së.”.

4. Paragrafi 3.01 i të Marrëveshjes ndryshohet në këtë mënyrë dhe zëvendësohet në tërësi me formulimin e mëposhtëm:

“3.01 Shpenzime të Pranueshme. Përfutuesi mund të tërheqë shumat e Grantit, në përputhje me dispozitat e: a) Kushteve standarde; b) këtij seksioni; dhe c) udhëzimeve shtesë që Banka Botërore mund të përcaktojë duke njoftuar Marrësin (përfshirë “Udhëzimet e disburseimit të Bankës Botërore për projektet” të muajit maj 2006, të rishikuar herë pas here nga Banka Botërore dhe të zbatueshme për këtë Marrëveshje në zbatim të këtyre udhëzimeve), për financimin e shpenzimeve të pranueshme siç përcaktohen në tabelën e mëposhtme. Tabela përcakton kategoritë e shpenzimeve të pranueshme që mund të financohen nga të ardhurat e Grantit (Kategoria), alokimet e shumave të Grantit për çdo kategori dhe përqindjen e shpenzimeve që do të financohen për shpenzimet e pranueshme në çdo kategori:

Kategoria	Shuma e Grantit të alokuar (e shprehur në euro)	Përqindja e shpenzimeve që do të financohen (përfshirë tatimet)
1) Mallra, shërbime të konsulentëve, shpenzime trajnimi dhe kosto operative për Projektin	3,815,107	100%
SHUMA TOTALE	3,815,107	

Për qëllime të këtij paragrafi, termi:

i) “Kostot rritëse operative” nënkupton kostot e arsyeshme për shpenzimet në rritje të kryera gjatë zbatimit të Projektit, të përbëra nga kosto të konsumit, kosto të marrjes me qira të automjeteve, operimit dhe mirëmbajtjes, kostot e komunikimit, tarifat bankare, shpenzimet e udhëtimit dhe dietat për stafin e Projektit për udhëtimet në lidhje me zbatimin e Projektit, shërbime të printimit dhe përkthimit, duke përfshirë shërbimet e konsulentëve dhe pagat e zyrtarëve të shërbimit civil të Marrësit; dhe

ii) “Trajnim” nënkupton kostot e arsyeshme, siç janë miratuar nga Banka Botërore, për trajnime dhe seminare të zhvilluara për Projektin, duke përfshirë kostot e mësimdhënies, udhëtimit dhe kostot e transfertave për pjesëmarrësit në trajnime dhe seminare, kostot që lidhen me sigurimin e shërbimeve të trajnuesve dhe relatorëve në seminare, marrjen me qira të materialeve për trajnim dhe seminare, dhe kosto të tjera që lidhen



drejtpërdrejt me përgatitjen dhe zhvillimin e kurseve të trajnimit dhe seminareve (por duke përjashtuar mallrat dhe shërbimet e konsulentëve).

Të gjithë termat dhe kushtet e tjerë të Marrëveshjes, me përjashtim të atyre të ndryshuara këtu, mbeten në fuqi dhe efekt të plotë.

Ju lutem, konfirmoni pëlqimin tuaj për amendimin e mësipërm, duke e nënshkruar dhe shënuar datën në këtë letër në hapësirën e dhënë më poshtë. Ky dokument amendimi do të nënshkruhet në dy kopje të njëjta, secila prej të cilave do të jetë origjinale dhe një prej të cilave do të na kthehet. Dispozitat e parashikuara në këtë letër amendimi do të hyjnë në fuqi në datën e njoftimit nga Marrësi për Bankën Botërore, për përfundimin e procedurave të tij të brendshme.

Me respekt,
BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM
SHOQATA NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM

Nga _____
Ellen Goldstein
Drejtor i Vendit
Njësia Vendore e Evropës Juglindore

PRANUAR:
REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga: _____
Përfaqësuesi i Autorizuar
Emri: _____
Titulli: _____
Datë: _____

VENDIM

Nr. 51, datë 27.1.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1; 14, pika 1; 18, pika 1; 25, pika 1 dhe 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (Lista e OKB-

së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës “C”, “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, çregjistrohet individi i renditur në shkronjën “a”, të listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për organizatën Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT

(LISTA E OKB-së)

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATËN AL-QAIDA

a) Lista e ndryshuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”:

1. ABD AL WAHAB, ABD AL HAFIZ.

Shënim. Gjenealitetet e tjera për personin, emri i të cilit është radhitur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

VENDIM

Nr. 53, datë 27.1.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 737, DATË 9.9.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË AKREDITIMIT DHE PËR TRAJNIMET E ORGANIZUARA NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E AKREDITIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të pikave 2, 3 e 8, të nenit 5, të ligjit nr. 116/2014, “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

Në pikën 20, të vendimit nr. 737, datë 9.9.2015, të Këshillit të Ministrave, fjalët “25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë” zëvendësohen me “2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 54, datë 27.1.2016

PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të pikës 1, të nenit 65, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Afrim Bakaj, Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU), lirohet nga kjo detyrë.

2. Z. Isuf Shehu emërohet drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 55, datë 27.1.2016

**PËR MIRATIMIN E PARAQITJES,
FORMËS DHE SPECIFIKIMEVE
TEKNIKE TË GRADAVE, SIMBOLEVE,
UNIFORMAVE DHE SHENJAVE TË
POLICISË SË SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 62, 97, 98, pika 1, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e paraqitjes, formës dhe specifikeve teknike të gradave, simboleve, uniformave dhe shenjave të Policisë së Shtetit, sipas albumit me 54 faqe, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Faqe | 576

2. Paraqitja, forma dhe specifikimet teknike të gradave janë përcaktuar në lidhjen nr. 1, të albumit.

3. Simbolet e Policisë së Shtetit janë flamuri dhe stema, të përcaktuara e të përshkruara në lidhjen nr. 2 të albumit.

4. Llojet e uniformës, që do të kenë në përdorim punonjësit e Policisë së Shtetit, do të jenë:

4.1 Uniforma bazë në detyrë:

a) dimërore;

b) verore.

4.2 Uniforma për stërvitje e shërbime;

4.3 Uniformat e veçanta;

4.4 Uniforma ceremoniale;

4.5 Veshja civile, e cila konvertohet në vlerë monetare.

Llojet e uniformave të përshkruara në pikat 4.1, 4.2, 4.3 dhe 4.4, të këtij vendimi, janë përcaktuar në lidhjen nr. 3, të albumit.

5. Shenjat dalluese të Policisë së Shtetit janë:

5.1 Shenja e mbiemrit/numri i identifikimit;

5.2 Shenja e kapelës;

5.3 Shenjat që vendosen në objektet e uniformës, sipas shërbimeve të Policisë së Shtetit, të përcaktuara si më poshtë vijon:

a) Shenja e krahut e Policisë së Rendit;

b) Shenja e krahut për Shqiponjat;

c) Shenja e krahut e Policisë së Kufirit dhe Migracionit;

ç) Shenja e krahut e Policisë Rrugore;

d) Shenja e krahut e Forcave Speciale “RENEA”;

dh) Shenja e krahut e Forcave të Ndërhijës së Shpejtë;

e) Shenja për kursantë/studentë;

ë) Shenja e jakës, përkrenare e Skënderbeut e stilizuar;

f) Shiriti i kapelës dhe kopsat me ngjyrë “të artë”.

Shenjat dalluese, të cituara më sipër, përcaktohen në lidhjen nr. 4 të albumit.

6. Ministri i Punëve të Brendshme, me urdhra apo udhëzime, miraton:

6.1 Normat e furnizimit me veshmbathje të punonjësve të Policisë së Shtetit;

6.2 Rregulloren e uniformës së punonjësve të Policisë së Shtetit;

6.3 Ndryshimet e mundshme të elementeve të veçanta të uniformës dhe shenjave dalluese etj., sipas ndryshimeve të strukturës e perspektivës së policisë, pa prekur, në tërësi, themelin e tyre;



6.4 Normat me veshje civile të punonjësve të Policisë, që trajtohen me këtë veshje, kompensimin e tyre në vlerë monetare;

6.5 Normat e materialeve të veshmbathjes, që janë në inventar të njërive shpenzuese;

6.6 Normat e pajisjeve për qentë e policisë;

6.7 Normat e materialeve të konsumit dhe të mirëmbajtjes;

6.8 Normat e veshmbathjes së posaçme dhe të rrobave të punës, falas;

6.9 Normat e veshmbathjes së punonjësve të Policisë së Shtetit që shkojnë me misione jashtë shtetit etj.

7. Drejtori i Policisë së Shtetit ka në kompetencë të miratojë:

7.1 Specifikimet dhe kushtet teknike të zbatimit të objekteve të uniformës, shenjave dhe elementeve të tjera të Policisë së Shtetit;

7.2 Zëvendësimin e materialeve të objekteve të uniformës, brenda vlerës së normës.

8. Gradat, simbolet, uniformat dhe shenjat e Policisë së Shtetit, të miratuara sipas këtij vendimi, për nga qëllimi i përdorimit, janë pronë e Drejtorisë së Policisë së Shtetit dhe përdoren vetëm gjatë

shërbimit ose për shkak të tij nga punonjësit e Policisë së Shtetit.

9. Gradat, simbolet, uniformat dhe shenjat e Policisë së Shtetit janë të patjetërsueshme. Ndalohet shumëfishimi dhe realizimi i modeleve e ngjyrave të tyre për përdorues të institucioneve apo subjekteve të tjera që trajtohen me uniformë, të cilat nuk kanë të njëjtën mision dhe detyra që ka Policia e Shtetit.

10. Vendimi nr. 79, datë 21.1.2009, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e stemës, të uniformës, gradave, emblemës, flamurit dhe shenjave të Policisë së Shtetit”, të ndryshuar, shfuqizohet.

11. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2016, miratuar për programin buxhetor “Policia e Shtetit”.

12. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



GRADAT, SIMBOLET, UNIFORMAT DHE SHENJAT E POLICISË SË SHTETIT

VITI 2016



PARATHËNIE

“Uniformat e policisë si vlerë shpirtërore e një kombi, si vlera më e rëndësishme e Policisë së Shtetit”.

Përdorimi i uniformës përbën prezantimin publik të strukturave të Policisë së Shtetit. Kjo sjell detyrime si në mënyrën e paraqitjes së uniformës ashtu dhe në qëndrimin dhe veprimin personal të mbajtësit.



PËRMBAJTJA

LIDHJA Nr. 1

PARAQITJA, FORMA DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE TË GRADAVE TË POLICISË SË SHTETIT... F. 4 – 14

LIDHJA Nr. 2

SIMBOLET E POLICISË SË SHTETIT. F. 15 – 17

LIDHJA Nr. 3

LLOJET E UNIFORMAVE TË POLICISË SË SHTETIT. F. 18 – 44

LIDHJA Nr. 4

SHENJAT E POLICISË SË SHTETIT..... F. 45 – 54



GRADAT E POLICISË SË SHTETIT

LIDHJA 1



LIDHJA 1

PARAQITJA, FORMA DHE TË DHËNAT TEKNIKE TË GRADAVE TË POLICISË SË SHTETIT,**Të dhënat teknike të përgjithshme, për Gradat e Policisë së Shtetit**

Gradat në Policinë e Shtetit, paraqitja dhe format e tyre që bëhen me një trajtim bashkëkohor, paraqesin harmonizimin dhe unifikimin e të gjithë elementëve përbërëse të tyre, janë të bukura në paraqitje e funksionale në përdorim.

Modelet e gradave në Policinë e Shtetit, sjellin përmirësime cilësore në vlerat estetike e përdoruese të uniformës së policisë, duke rritur dinjitetin e punonjësve të Policisë së Shtetit.

Gradat e policisë së shtetit janë të ndara në tre grupe: në Grada të mëdha spaleti shërbimi, Grada të mëdha spaleti ceremoniali dhe Grada të vogla gjoksi.

Format e Gradave të mëdha spaleti shërbimi dhe Gradave të mëdha spaleti ceremoniali, për të gjitha nivelet paraqiten në një tekstil ngjyrë blu të errët të përforcuar nga brenda me një shtresë klorur polivinili (PVC), të palosur në formë trapezi (tubolare). Perimetri i trapezit është i rrethuar (konturohet) nga një kornizë/shirit plastik me ngjyrë të kuqe i punuar artistikisht në relief.

Në brendësi të shiritit rrethues janë vendosur në varësi të nivelit të gradës elementet në relief në material plastik si shirit plastik drejtkëndësh, shirit plastik me motive, yjet me dimensionet të ndryshme, përkrenarja e Skënderbeut, janë të punuara artistikisht në relief, imitim qendisje, me ngjyrë të artë, që sjell një mënyrë pushteti dhe triumfi të veçantë për përdorimin e uniformës së policisë së shtetit. Punimi i gradave është realizuar nga saldimi dhe presioni i duhur në brendësi të stampës të gradës, të gjithë elementeve duke realizuar kështu relievet e vendosura dhe të kërkuara mbi gradë. Vendosja e elementeve në bazë të teknologjisë e punimit bëhet me stampim në të nxehtë dhe në presion të elementeve plastike. Ngjitja e elementeve të veçantë të plastikës duhet të jetë uniform dhe homogjen për të siguruar rezistencën maksimale nga shqitja.

Të gjithë elementet plastike janë në metalizim me fletë metalike të artë duke ruajtur efektin e punimeve të imta që kërkon modeli, ashtu dhe për ruajtjen e shkëlqimit të ngjyrave. Pas kësaj elementet plastike mbrohen nga një fletë plastike të tejdukshme e ngjitur në mënyrë organike me elementet për ta ruajtur nga oksidimet eventuale që mund të vijnë nga agjentët atmosferike. Secila nga grupet janë të specifikuara në raport korelativ të gradës që ajo përfaqëson, për një qëndrueshmëri kohore, fleksibilitet dhe ndjeshmëri.

Gradat e mëdha spaleti shërbimi, Grada të mëdha spaleti ceremoniali për vetë pozicionin e tyre janë në formë tubulare dhe me pamje të sipërme trapezoidale. Konkretisht për gradat Inspektor deri në gradat Drejtues i Parë dimensionet janë 60 mm x 58 mm dhe me gjatësi 90 mm, ndërsa për gradat Drejtues i Lartë dhe Drejtues Madhor gjatësia shkon 105 mm. Toleranca e dimensionit apo e pozicionimit të elementëve të gradave është +/- 1mm.



Lënda e parë (Materiali) që do të përdoret është tekstil blu ngjyrë blu i errët, përzierja; 67% pambuk - 33 % fibër poliestër +/- 3%. Pesha e tekstit 125 gr/m² +/- 5 gr.

Gradat e vogla të gjoksit, janë në formë drejtkëndëshi me dimension të jashtme të unifikuara prej 86 mm x 30 mm. Toleranca e dimensionit apo e pozicionimet te elementëve te gradave është +/- 1mm. Gradat e gjoksit në pjesën e pasme kanë të qepur në mënyrë solide një material me efekt ngjitës (velkrof-ana mashkull) që e bën gradën të jetë e çmontueshme nga velkrof femër që është e qepur në objektet e uniformës.

Gradat janë realizuar me material plastik me bazë PVC, me termofiksim dhe me shtresë mbrojtëse nga përpara. Baza është me fushë ngjyrë blu të errët me dimensione; gjatësi 82 mm, gjerësi 26 mm. Në pjesën e brendshme të gradës, në brendësi të shiritit rrethues janë vendosur në varësi të nivelit të gradës elementet në relief në material plastik janë të punuara artistikisht në relief, imitim qëndisje. me ngjyrë të artë. Janë të ndërtuara nga një kornizë perimetrale 2,5 – 3 mm në ngjyrë të kuqe. Drejtkëndëshi është i përbërë nga një masë e mjaftueshme plastike, e punuar në të nxehtë, në stampën e cila paraqet në relief formën e gradës, të përfshira brenda kornizës.

E gjithë grada është e veshur për mbrojtje me një fletë plastike transparente, në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen nga proceset e oksidimit që vijnë nga agjentët atmosferike.


Në vijimësi të këtij materiali pasqyrohen dukshëm paraqitja dhe format sipas llojeve të gradave të Policisë së Shtetit sipas nenit 51 të ligjit 108/2014 datë 31.07.2014 “Për Policinë e Shtetit”, gradat në Policinë e Shtetit, sipas rendit hierarkik rritës, emërtohen si më poshtë:

1. INSPEKTOR
2. NENKOMISAR
3. KOMISAR
4. KRYEKOMISAR
5. DREJTUES
6. DREJTUES I PARË
7. DREJTUES I LARTË
8. DREJTUES MADHOR




Fig. Nr. 1:

GRADË E MADHE SPALETI SHËRBIM “INSPEKTOR”



GRADË E MADHE SPALETI CEREMONIALI “INSPEKTOR”




GRADË E VOGËL GJOKSI “INSPEKTOR”






GRADË E MADHE SPALETI SHËRBIMI “NËNKOMISAR”

Fig. Nr. 2:



GRADË E MADHE SPALETI CEREMONIALI “NËNKOMISAR




GRADË E VOGËL GJOKSI “NËNKOMISAR”






Fig. Nr. 3:

GRADË E MADHE SPALETI SHËRBIMI “KOMISAR”



GRADË E MADHE SPALETI CEREMONIALI “KOMISAR”




GRADË E VOGËL GJOKSI “KOMISAR”



Fig. Nr. 4:

GRADË E MADHE SPALETI SHËRBIMI “KRYEKOMISAR”



GRADË E MADHE SPALETI CEREMONIALE “KRYEKOMISAR”




GRADË E VOGËL GJOKSI “KRYEKOMISAR”



Fig. Nr. 5:

GRADË E MADHE SPALETI SHËRBIMI “DREJTUES”



GRADË E MADHE SPALETI CEREMONIALE “DREJTUES”




GRADË E VOGËL GJOKSI “DREJTUES”





Fig. Nr. 6:

GRADË E MADHE SPALETI SHËRBIMI “DREJTUES I PARË”



GRADË E MADHE SPALETI CEREMONIALE “DREJTUES I PARË”



GRADË E VOGËL GJOKSI “DREJTUES I PARË”





Fig. Nr. 7:**GRADË E MADHE SPALETI SHËRBIMI “DREJTUES I LARTË”****GRADË E MADHE SPALETI CEREMONIALE “DREJTUES I LARTË”****GRADË E VOGËL GJOKSI “DREJTUES I LARTË”**

Fig. Nr. 8:**GRADË E MADHE SPALETI SHËRBIMI “DREJTUES MADHOR”****GRADË E MADHE SPALETI CEREMONIALE “DREJTUES MADHOR”****GRADË E VOGËL SHËRBIMI “DREJTUES MADHOR”**



SIMBOLET E POLICISË SË SHTETIT

LIDHJA 2

FLAMURI I POLICISË SË SHTETIT



Pjesa valëvitëse e flamurit:

Drejtëndësh me përmasa me raport 1:1,4, i ndarë vertikalisht në dy pjesë të barabarta blu dhe e kuqe. Në qendër shqiponja dykrenare sipas modelit të flamurit kombëtar, e ndarë vertikalisht në dy pjesë të barabarta e kuqe dhe e zezë. Mbi shqiponjën, është vendosur përkrenarja e Skënderbeut, me ngjyrë të artë, e stilizuar sipas figurës.

Poshtë shqiponjës, shkrimi “**POLICIA E SHTETIT**” i artë.

Pjesa jovalëvitëse e flamurit:

Përbëhet nga një shtizë cilindrike, me majë, sipas figurës, ngjyrë ari.

STEMA E POLICISË SË SHTETIT



Stema e Policisë së Shtetit përbëhet:

Mburojë (Shqyt), e ndarë vertikalisht në dy pjesë të barabarta blu dhe e kuqe. Në qendër të shqytit shqiponja dykrenare me përkrenaren e Skënderbeut të vendosur sipër saj, të dyja me relief dhe të stilizuara sipas figurës. Në gjoks të shqiponjës një mburojë (shqyt) e vogël, e kuqe, me në qendër shqiponjën e zezë të flamurit kombëtar.

Në pjesën e sipërme të mburojës (shqytit), shkrimi ‘**POLICIA E SHTETIT**’ ngjyrë ari.

Përreth mburojës (shqytit) kornizë ari.



UNIFORMAT E POLICISË SË SHTETIT

LIDHJA 3



INDEKSI

1. UNIFORMA BAZË NË DETYRE DIMËRORE

- 1 Xhup shërbimi (3/4)(me veshje të ngrohtë)
- 2 Xhup shërbimi (me veshje të ngrohtë)
- 3 Kostum uniforme për meshkuj/femra (1 Xhaketë, 2 palë pantallona, 2 kapele)
- 4 Pulovër e trikotuar jakë “V”
- 5 Këmishë bojë qielli me mëng të gjata, për meshkuj/ femra
- 7 Kravatë blu uniforme
- 8 Këpucë me qafa dimërore për meshkuj/ femra
- 9 Rrip pantalloni
- 10 Rrip multifunksional
- 11 Jelek multifunksional
- 12 Pelerinë shiu
- 13 Doreza lëkure

3. UNIFORMA PËR STËRVITJE E SHËRBIME

- 1 Kostum doku stërvitje (Xhaketë, pantallona, kapele tip sport).
- 2 Bluzë pambuku, jakë rrumbullakët m/ gjata
- 3 Bluzë pambuku, jakë rrumbullakët m/ shkurtra
- 4 Këpucë me qafa stërvitje (Kambale)

5. UNIFORMA CEREMONIALE

- 1 Këmishë ceremoniale femra/ meshkuj
- 2 Rrip ceremoniali
- 3 Doreza të bardha ceremoniale

2. UNIFORMA VERORE

- 1 Pantallona vere për meshkuj/ femra
- 2 Këmishë bojë qielli me mëng të shkurtra, për meshkuj/ femra
- 3 Bluzë blu pambuku me 2 kopsa, me mëng të shkurtra
- 4 Këpucë gjysma verore për meshkuj/ femra

4. UNIFORMA TË VEÇANTA

- 1 Uniforma e Policisë Rrugore. Uniformë dimërore dhe verore), Jelek fosforeshent, Mbulesë kapele, Doreza motoçiklisti,.
- 2 Uniforma e veçantë verore për punonjësit e policisë që kryejnë shërbimin në plazhe, gjatë sezonit turistik. Bluzë pambuku e bardhë m/sh, Pantallona të shkurtra, kepuce tip atlete, kapele sport
- 3 Uniforma e veçantë për Punonjësit e Policisë Seksioni i Forcës së Posaçme SHQIPONJA dhe të Njesisë së Ndërhijes së Patrullave me motoçikleta. (Uniformë dimërore dhe verore)
- 4 Uniforma e veçantë për punonjësit e Policisë së Rendit, patrullë e përgjithshme (Unif. dimërore /verore)
- 5 Uniforma e Forcave Speciale “RENEA”.
- 6 Uniformat e Ndërhijes së Shpejtë (Kostum doku shërbimi,)
- 7 Uniforma për punonjësit e Policisë të Mjeteve Ujore: Jelek shpëtimi fosforeshent.
- 8 Uniforma e Prezantimit të Policisë së Hetimit të Krimit: Jeleku prezantues , Kapele prezantuese.
- 9 Veshje të ngrohta: Pulovër leshi e trikotuar jakë rrumbullakët, Kapuç leshi i trikotuar



UNIFORMA BAZË DIMËRORE NË DETYRË

1. XHUP SHËRBIMI ¾ (ME VESHJE TË NGROHTË)



2. XHUP SHËRBIMI (ME VESHJE TË NGROHTË)





UNIFORMA E SHËRBIMIT

3. KOSTUM UNIFORME PËR MESHKUJ

•XHAKETË, PANTALLONA, KAPELE



3.1.KOSTUMI I UNIFORMËS PËR FEMRA

•XHAKETË , PANTALLONA/ FUND, KAPELE





**KËMISHË BOJË QIELLI
M/GJATA MESHKUJ**



**KËMISHË BOJË QIELLI
M/GJATA FEMRA**



**KRAVATATË
UNIFORME BLU**



**PULOVËR E TRIKOTUAR
JAKË “V”**



**KËPUCË ME QAFÄ DIMËRORE
PËR MESHKUJ DHE FEMRA**



DORËZÄ LËKURË



**RRIP PANTALLONI
UNIFORMË**



RRIP MULTIFUNKSIONAL





JELEK MULTIFUNKSIONAL





PELERINË SHIU





UNIFORMA VERORE

**PANTALLONA VERE
MESHKUJ**



**PANTALLONA/FUND
VERE FEMRA**



**KËMISHË BOJË QIELLI
M/SHKURTRA MESHKUJ**



**KËMISHË BOJË QIELLI
M/SHKURTRA FEMRA**



**BLUZË PAMBUKU BLU, ME 2 KOPSA ME MËNG
TË SHKURTRA.**



**KËPUCË ½ VERE
MESHKUJ**



**KËPUCË ½ VERE
FEMRA**



**KËPUCË ½ ME
QAFA, SHËRBIMI**





UNIFORMA PËR STËRVITJE E SHËRBIME

- KOSTUM DOKU (RIP STOP)
- XHAKETË
- PANTALLONA
- KAPELE TIP SPORT



**BLUZË PAMBUKU ME JAKË
TË RRUMBULLAKËT, ME
MËNG TË GJATA**



**BLUZË PAMBUKU ME JAKË TË
RRUMBULLAKËT, ME MËNG TË SHKURTRA**





UNIFORMAT E VEÇANTA

1. UNIFORMA E POLISË RRUGORE

DIMERORE KOSTUM MOTOÇIKLISTI (XHUP, PANTALLONA)



•1.1 UNIFORMA VERORE TË POLICISË RRUGORE

BLUZË PAMBUKU M/SH ME 2 KOPSA, PANTALLONA DOKU





XHUP FOSFORESHENT




JELEK FOSFORESHENT





ARTIKUJ TË POLICISË RRUGORE

MBULESË KAPELE



**MËNGORE
FOSFORESHENTE**



DOREZA MOTOÇIKLISTI



2. UNIFORMA E VECANTË VERORE PËR PUNONJËSIT E POLICISË QË KRYEJNË SHËRBIMIN NË PLAZHE, GJATË SEZONIT TURISTIK.

- BLUZË ME DY KOPSA E BARDHË ME MËNG TË SHKURTRA
- PANTALLONA TË SHKURTRA PËR MESHKUJ/ FEMRA
- KËPUCË TIP ATLETE
- KAPELE TIP SPORT



Meshkuj



Femra





3. UNIFORMA E VECANTË PËR PUNONJËSIT E POLICISË SEKSIONI I FORCËS SË POSAÇME SHOIPONJA DHE TË NJESISE SE NDERHHYRJES SE PATRULLËS ME MOTOCIKLETA. (UNIFORMË DIMËRORE DHE VERORE)

KOSTUM MOTOÇIKLISTI (Xhup, pantallona)

•BLUZË PAMBUKU M/SH ME 2 KOPSA, PANTALLONA DOKU



4. UNIFORMA E VECANTE PER PUNONJESIT E POLICISE SË RENDIT, PATRULLË E PËRGJITHSHME

- **UNIFORMA DIMËRORE XHUP, PANTALLONA**



- **UNIFORMA VERORE** BLUZË PAMBUKU M/SH ME 2 KOPSA, PANTALLONA DOKU + KAPELE SPORT





4. UNIFORMA E FORCAVE SPECIALE **“R E N E A”**

- I. UNIFORMË OPERACIONALE DIMËRORE**
- II. UNIFORMË OPERACIONALE PRANVERË – VJESHTË**
- III. UNIFORMË OPERACIONALE VERORE**
- IV. AKSESORË**



•UNIFORMË OPERACIONALE DIMRI

KOMINOSHE OPERACIONALE



•XHUP DIMRI



•KAPELE OPERACIONALE



•KEPUCË TAKTIKE E FORCAVE SPECIALE



•DOREZA TAKTIKE DIMRI





II. UNIFORMË OPERACIONALE PRANVERË - VJESHTË

•XHUP TAKTIK PRANVERË - VJESHTË



•KËPUCË PRANVERË – VJESHTË



•KOMINOSHE PRANVERË - VJESHTË



•DOREZA TAKTIKE PRANVERË - VJESHTË





III. UNIFORMË OPERACIONALE VERORE

BLUZË TAKTIKE VERE



**PANTALLONA
TAKTIKE VERE**



XHAKETË TAKTIKE VERE



KËPUCË TAKTIKE VERE



RRIP TAKTIK



MASKË OPERACIONALE





JELEK OPERACIONAL (CIVIL)



PANTALLONA OPERACIONALE (CIVILE)





UNIFORMAT E NDËRHYRJES SË SHPEJTË

KOSTUM DOKU (RIP-STOP)
(XHAKETË, PANTALLONA
DHE KAPELE)



BLUZË PAMBUKU
BLU ME DY KOPSA



PANTALLONA DOKU
ME RIP STOP



7. UNIFORMA E VEÇANTË PËR PUNONJËSIT E POLICISË TË MJETEVE UJORE

JELEK SHPËTIMI FOSFORESHENT



8. UNIFORMA E PREZANTIMIT TË POLICISË SË HETIMIT TË KRIMIT.

•JELEK PREZANTUES HETIMI I KRIMIT



•KAPELE PREZANTUESE HETIMI I KRIMIT





VESHJE E NGROHTË PËR ZONAT VERIORE DHE JUGLINDORE

PULOVËR LSHI E TRIKOTUAR



KAPUÇ LSHI I TRIKOTUAR





RRIP CEREMONIAL



KËMISHË CEREMONIAL M/F




DOREZA CEREMONIALI





KORDONE PER UNIFORMEN CEREMONIALE





SHENJAT E POLICISË SË SHTETIT

LIDHJA 4



SHENJA MBIEMRI, NUMER IDENTIFIKIMI



•SHENJA E KAPELES, (EMBLEMA)



Shqiponjë dykrerëshe me përkrenaren e Skendërbeut, të vendosur sipër saj. E gjitha e artë, me relief dhe e stilizuar sipas figurës.

SHENJAT SIPAS SHËRBIMEVE TË POLICISË

□ SHENJË KRAHU POLICIA E RENDIT



Mburojë (Shqyt) e ndarë vertikalisht në dy pjesë, e kuqe dhe e zezë, me kornize të artë. Në pjesën e poshtme të mburojës (shqytit), janë të shkruara fjalët **“POLICIA E RENDIT”** të arta. Brenda mburojës (shqytit), një mburojë (shqyt) më e vogël blu me kornizë të artë. Brenda tij në qendër, e vendosur një shpatë e argjendtë e vendosur vertikalisht dhe përkrenarja e Skenderbeut e artë.

❑ SHENJË KRAHU PER SHQIPONJAT



Mburojë (Shqyt) e kuqe me në qendër kokë shqiponje e zezë me shikim majtas, me sqep dhe gjuhë të artë. Në pjesën e sipërme të shqytit, fjala “**SHQIPONJAT**” e artë.
Në 1/3 e poshtme të shqytit, trekendesha blu e kuq të ndërthurur.



☐ SHENJË KRAHU POLICIA RRUGORE



Mburojë (Shqyt) e zezë me kornizë të kuqe. Në pjesën e sipërme të shqytit motiv shahu bardhë e zi. Në pjesën e poshtme të mburojës (shqytit), fjalët “**POLICIA RRUGORE**” ngjyrë e verdhë fluoreshente.

Në qendër, një mburojë (shqyt) më e vogël ngjyrë e verdhë fluoreshente me një pishtar blu me flakë të kuqe dhe një rrotë.

SHENJË KRAHU POLICIA KUFIRIT DHE MIGRACIONIT



Mburojë (Shqyt) e zezë, me kornizë të artë. Në pjesën e sipërme, në fushë të kuqe fjalët “**POLICIA KUFITARE**” me ngjyre ari. Në cepin e poshtëm, përkrenarja e Skënderbeut e stilizuar e artë. Në qendër një mburojë (shqyt) më i vogël e blertë, me hartën e Shqipërisë ngjyrë gri.

☐ SHENJE KRAHU E FORCAVE SPECIALE

Mburojë (Shqyt) e kuqe me kornizë të artë, me cepin e sipërm të majtë të ngrënë.
Në fushë, krah i majtë që del nga e djathta, i armuar, gri, që shtrëngon një rrufe të artë.
Poshtë, në shirit horizontal blu, inicialet “**RENEA**” të arta.

□ SHENJË KRAHU E NDËRHJRJES SË SHPEJTË


Mburojë (Shqyt) e kuqe me kornizë të artë, me cepin e sipërm të majtë të ngrënë.

Në fushë, krah i majtë që del nga e djathta, i armuar, gri, që shtrëngon një shigjetë të artë me majën lart. Poshtë, në shirit horizontal blu, inicialet “FNSH” të arte.




Fig. Nr. 1:

SHENJA PËR KURSANTË/ STUDENTE



SHENJË CEREMONIALI KURSANTI/STUDENTI



SHENJË GJOKSI KURSANTI/STUDENTI





SHENJA E JAKËS PËRKRENARE E STILIZUAR



KOPSAT

Kopsa të vogla,
Ø 15 mm



Kopsa të mesme,
Ø 23 mm



Kopsa të mëdha, Ø 25 mm



SHIRITI I ZIL KAPELES



**VENDIM**

Nr. 56, datë 27.1.2016

**PËR NJË SHITESË FONDI NË
BUXHETIN E VITIT 2016, MIRATUAR
PËR MINISTRINË E PUNËVE TË
BRENDSHME, PËR MARRJEN E
MASAVE PARANDALUESE, SI PASOJË E
SITUATËS EMERGJENTE TË KRIJUAR
NGA RRËSHQITJA E TOKËS, NË
NJËSINË ADMINISTRATIVE FARKË,
BASHKIA TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 13, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, dhe të shkronjës “dh”, të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 8756, datë 26.3.2001, “Për emergjencat civile”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Punëve të Brendshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2016, t’i shtohet fondi prej 30 023 451 (tridhjetë milionë e njëzet e tre mijë e katërqind e pesëdhjetë e një) lekësh, për Bashkinë Tiranë, për marrjen e masave parandaluese, si pasojë e situatës emergjente të krijuar nga rrëshqitja e tokës, në njësinë administrative Farkë, në zonën pranë Xhamisë së Selitës, nga reshjet e datës 22.11.2015.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit të vitit 2016.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

VENDIM

Nr. 58, datë 27.1.2016

**PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA
MINISTRIA E MBROJTJES TË BASHKIA
GRAMSH, TË PRONËS NR. 334, ME
EMËRTIM “ISH-REPARTI USHTARAK
NR. 9920, GRUP DEPO”, ME
VENDNDODHJE “PËRROI I
ÇEKREZIT”, GRAMSH, DHE PËR NJË
NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515,
DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE
TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË
CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË
MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes të Bashkia Gramsh, të pronës nr. 334, me emërtim “Ish-reparti ushtarak nr. 9920, Grup Depo”, me vendndodhje “Përroi i Çekrezit”, Gramsh, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për ndërtimin e impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane, në territorin e Bashkisë Gramsh.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të hiqet prona nr. 334, me emërtim “Ish-reparti ushtarak nr. 9920, Grup Depo”, me vendndodhje “Përroi i Çekrezit”, Gramsh, dhe të shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i janë transferuar në pronësi ose në përdorim Bashkisë Gramsh.

3. Bashkisë Gramsh i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës së



përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, kryetari i Bashkisë Gramsh, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të


Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PLAN VENDOSJA E ISH REP. USHT. NR.9920 PRONA NR.334
GRUP DEPO PËRROI I CEKREZIT, GRAMSH.

Sistemi i koordinatave shtetërore





VENDIM

Nr. 59, datë 27.1.2016

**PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË
MENAXHIMIT TË SHPENZIMEVE
PUBLIKE PËR VITIN 2016**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të nenit 22, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike për vitin 2016, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Integritimit Evropian, Departamenti i Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj, në Kryeministri, dhe të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2016.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LIDHJA NR. 1

KALENDARI I MENAXHIMIT TË SHPENZIMEVE PUBLIKE PËR VITIN 2016

PERIUDHA	DATA	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	VEPRIMI PERKATES
Janar	15	MF	Përgatit dhe paraqet në KM Kalendarin e MSHP
Janar	21	KM	Shqyrton dhe miraton Kalendarin e MSHP
Janar	15	MF	Paraqet në KM Kuadrin Makroekonomik e Fiskal 2017 - 2019
Janar	21	KM	Miraton Kuadrin Makroekonomik e Fiskal 2017 - 2019
Shkurt	19	MF	Paraqet në KM tavanet e përgatitjes së PBA 2017-2019 dhe limitet e angazhimeve të reja
Shkurt	24	KM	Shqyrton dhe miraton tavanet e përgatitjes së PBA 2017-2019
Shkurt	29	KM	Paraqet për informacion në Kuvend Kuadrin Makroekonomik e Fiskal si dhe Tavanet e përgatitjes së PBA 2017-2019
Shkurt	29	MF	Dërgon Udhëzimin e Përgatitjes së Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme
Mars - Prill	1 Mars - 29 Prill	Njësite e Qeverisjes Qendrore	Përgatisin kërkesat e tyre buxhetore
Maj	2	Njësite e Qeverisjes Qendrore	Paraqesin në MF kërkesat e tyre buxhetore
Maj	3 - 20	MF, MZHETTS, MIE dhe DPZHFNH	Kryejnë analizat e kërkesave buxhetore
Maj - Qershor	23 Maj - 3 Qershor	MF, MZHETTS, MIE dhe DPZHFNH	Organizon seancat dëgjimore me Njësitë e Qeverisjes Qendrore
Qershor	6	MF	Paraqet në KM Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të Rishikuar (<i>ne rast se shihet e nevojshme</i>)
Qershor	8	KM	Miraton Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të Rishikuar (<i>ne rast se shihet e nevojshme</i>)
Qershor	13-23	MF	Përgatit dokumentin e PBA 2017-2019, tavanet e reja të shpenzimeve të PBA 2017-2019 dhe limitet e angazhimeve të reja
Qershor	24	MF	Paraqet dokumentin e PBA 2017-2019, tavanet e reja të shpenzimeve dhe limitet e angazhimeve të reja, për shqyrtim dhe miratim në KM
Qershor	29	KM	Miraton dokumentin e PBA 2017-2019 dhe tavanet e reja të shpenzimeve të PBA 2017-2019
Korrik	4	MF	I paraqet Kuvendit për informacion dokumentin e PBA 2017-2019
Korrik	8	MF	Dërgon Udhëzimin Plotësues të Përgatitjes së Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme
Korrik - Gusht	11 Korrik - 31 Gusht	Njësite e Qeverisjes Qendrore	Përgatisin kërkesat e rishikuara buxhetore
Shtator	1	Njësite e Qeverisjes Qendrore	Paraqesin në MF kërkesat e rishikuara buxhetore
Shtator	2-23	MF, MZHETTS, MIE dhe DPZHFNH	Kryejnë analizat e kërkesave të rishikuara buxhetore
Shtator - Tetor	26 Shtator - 7 Tetor	MF, MZHETTS, MIE dhe DPZHFNH	Organizon seancat dëgjimore me Njësitë e Qeverisjes Qendrore
Tetor	7	MF	Paraqet në KM Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të Rishikuar (<i>ne rast se shihet e nevojshme</i>)
Tetor	12	KM	Miraton Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të Rishikuar (<i>ne rast se shihet e nevojshme</i>)
Tetor	13-21	MF	Përgatit Projektbuxhetin e vitit 2017 si dhe dokumentin e rishikuar të PBA 2017-2019 dhe i paraqet për shqyrtim në KM
Tetor	26	KM	Miraton Projektbuxhetin e vitit 2017 si dhe dokumentin e rishikuar të PBA 2017-2019
Tetor	28	MF	Dërgon për informacion në Kuvend një kopje të dokumentit të rishikuar të PBA 2017-2019, të miratuar nga KM
Tetor	31	KM	I paraqet Kuvendit Projektbuxhetin e vitit 2017

**VENDIM****Nr. 60, datë 27.1.2016****PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 149, DATË 29.2.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE PËR PUNONJËSIT E DREJTORISË SË SHËRBIMEVE QEVERITARE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 149, datë 29.2.2012, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Lidhja nr. 1, e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numërtim dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Shkronjat “a” e “b”, të pikës 1, riformulohen, si më poshtë vijon:

“a) Kategoria ose klasa për çdo funksion, kolona 2, e lidhjes nr. 1. Vlera mujore e pagës për çdo kategori dhe klasë është e njëjtë me vlerën e pagës për kategorinë dhe klasën, të përcaktuara me vendimin përkatës për nëpunësit civilë dhe për punonjësit mbështetës të administratës publike.

b) Paga e grupit, kolona 3, e lidhjes nr. 1, e cila përfitohet vetëm për nëpunësit me arsim të lartë universitar në funksionet e përcaktuara në këtë lidhje. Vlera mujore e pagës së grupit është e njëjtë me vlerën e pagës së grupit, e përcaktuar me vendimin përkatës për nëpunësit civilë.”.

c) Lidhja nr. 2 dhe lidhja nr. 3, përmendur në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të vendimit, shfuqizohen.

2. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë në datën 1 janar 2016 dhe përballohen nga fondet e planifikuara për vitin 2016, për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



LIDHJA NR. 1
STRUKTURA E PAGËS SË PUNONJËSVE TË DREJTORISË SË SHËRBIMIT QEVERTITAR

Funksioni	Kategoria Klasa	Paga e grupit (lekë)	Shtesa për vjetërsi (%)	Shtesa për kushte pune (lekë) bëhet
1	2	3	4	6
Drejtor	I-b	1	2%	
Zëvendësdrejtor	II-b	1	2%	
Drejtor Njësie, Drejtor në Pallatin e Kongreseve	III-a	1	2%	
Jurist, përgjegjës i Pallatit të Kongreseve, i Pallatit të Brigadave dhe përgjegjës i qendrave	III-a/1	1	2%	
Specialist Auditit	III-b	1 ose 2 ose 3	2%	
Sekretar (i titullarit dhe i Bordit Drejtues)	IV-b	1 ose 2 ose 3	2%	7000
Specialist kontabilist; specialist merceolog; specialist i burimeve njerëzore; specialist inxhinier; specialist i prokurimeve në njësitë qendrore; specialist administrues në: Sarandë, Pogradec, Vila 4, Vila 30, Vila 31 dhe Vila Dajt; specialist i financës Durrës; specialist gjelbërimi i Pallatit të Brigadave	IV-a	1 ose 2 ose 3	2%	
Specialist njësie; specialist protokoll-arkivi; specialist administrues në Vilën Velipojë; specialist gjelbërimi qendra Durrës; specialist i Pallatit të Kongreseve; sekretar për ish-presidentët	IV-b	1 ose 2 ose 3	2%	
Kryekuzhinier i aktiviteteve kryesore	X		1%	43500
Përgjegjës i vilave nr. 4 Tiranë, nr. 30 Tiranë, nr. 31 Tiranë dhe administrues i Qendrës Vlorë-Dhërmi	X		1%	12700
Përgjegjës i Brigadës Teknike; përgjegjës vile	X		1%	7300
Magazininier i magazinës qendrore; kryepunëtor gjelbërimi; kamerier/banakier në Presidencë, në Kryeministri dhe në Kryesinë e Kuvendit; Punëtorë në rezidencën, familjen ose shtëpinë e Presidentit/e Kryetarit të Kuvendit /e Kryeministrit	IX		1%	
Kryepastiçier	IX		1%	17800
Magazininier (magazinë dytësore); teknik në sektorin e shërbimeve teknike; teknik në vilën nr. 31; teknik mirëmbajtje në Qendrën Vlorë-Dhërmi; teknik në Pallatin e Brigadave; teknik mirëmbajtjeje Dajt; banakier në Pallatin e Kongreseve; banakier/kamerier në Sallën e Kuvendit; kamarier/kuzhinier Qendra Vlorë-Dhërmi; punëtor/kamerier, Vila 30; punonjës në Qendrën Rezidenciale Durrës (Vila 6, Vila 20, Vila 13 dhe Vila 23); kamerier dhe ndihmëskuzhinier, Vila nr. 31 Tiranë	VIII		1%	
Kuzhinier/kamerier në rezidencën, familjen ose shtëpinë e Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit; kryekamerier Vila 30 dhe Vila 31	VIII		1%	17800
Kuzhinier, Vila 31; pastiçier	VIII		1%	12700
Banakier dhe përgjegjës material, Vila 31	VIII		1%	7300
Banakier/Kamerier në Gjykata Kushtetuese; kamerier në Pallatin e Kongreseve; punëtor/kamerier në Vilën Dajt dhe Pogradec; shofer; teknik i Qendrës së Transportit; teknik i Pallatit të Kongreseve; teknik në Pogradec; teknik në Qendrën Durrës dhe Sarandë; ndihmësmagazininier; punëtorë dhe përgjegjës material, Vila 29 Durrës; rrobaqepës	VII		1%	
Punëtorë pastrimi lavanterie, gjelbërimi, rojë, bahçevan, punëtor mirëmbajtjeje	V		1%	

**VENDIM****Nr. 62, datë 27.1.2016**

**PËR MIRATIMIN E ZBATIMIT TË
PROCEDURËS SË THJESHTUAR PËR
NDRYSHIMIN E PLANIT KOMBËTAR
SEKTORIAL PËR GAZSJELLËSIN TRANS
ADRIATIK (PROJEKTI TAP), TË
MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 1, DATË
4.7.2013, TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË
TERRITORIT, “PËR MIRATIMIN E
PLANIT KOMBËTAR SEKTORIAL PËR
GAZSJELLËSIN TRANS ADRIATIK
(PROJEKTI TAP)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 17 e 26, pika 3, të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të nenit 3, të ligjit nr. 73/2015, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të pikës 27.1, të nenit 27, dhe të pikës 6/1/b, nënndarja “iii”, e pjesës 1, të shtojcës 1, të marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, lidhur me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP)”, ratifikuar me ligjin nr. 116/2013, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e zbatimit të procedurës së thjeshtuar për përgatitjen, shqyrtimin dhe miratimin e ndryshimit të Planit Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik (Projekti TAP), të miratuar me vendimin nr. 1, datë 4.7.2013, të Këshillit Kombëtar të Territorit, “Për miratimin e Planit Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik (Projekti TAP)”.

2. Miratimi i ndryshimeve të Planit Kombëtar Sektorial për projektin TAP bëhet sipas procedurave të mëposhtme:

a) Komisioni i Vlerësimit Teknik në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, si ministria përgjegjëse për koordinimin në përgatitjen e shtesës së Planit Kombëtar Sektorial për projektin TAP, kryen shqyrtimin teknik të Planit Kombëtar Sektorial, brenda 15 ditëve nga data e përfundimit të përgatitjes së dokumentit.

b) Në përfundim të procedurave të shqyrtimit, Komisioni i Vlerësimit Teknik harton raportin e vlerësimit teknik të ndryshimit të Planit Kombëtar Sektorial, të cilin, pas miratimit të ministrit, ia përcjell sekretariatit teknik të KKT-së dhe e boton vendimin në regjistër.

3. Procedurat e thjeshtuara për përgatitjen dhe shqyrtimin e ndryshimit të Planit Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik (Projekti TAP) kanë për qëllim të shkurtojnë afatet e procesit të hartimit dhe konsultimit të dokumenteve respektive të planifikimit sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi, si dhe të përfshijnë çështje që nuk prekin qëllimet e përmbajtjen e këtij plani dhe nuk cenojnë vlerat natyrore, cilësinë e mjedisit, zonat e mbrojtura, tokat bujqësore, biodiversitetin dhe trashëgiminë natyrore e kulturore në zonat ku do të bëhen ndryshimet e PKS-së për projektin TAP.

4. Përgatitja e ndryshimit të Planit Kombëtar Sektorial për projektin TAP bëhet nën koordinimin e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, si ministria përgjegjëse për sektorin energjetik, e cila përgatit planin e veprimit dhe grafikun kohor, bën vlerësimin e kompletimit të dokumentacionit të ndryshimit të PKS-së për projektin TAP, mbi bazën e materialit “Të dhëna për një ndryshim në Planin Kombëtar Sektorial të Projektit TAP” e të materialit grafik përkatës, të paraqitura nga TAP AG, si dhe siguron një proces konsultimi me palët e interesuara përpara fillimit dhe gjatë hartimit të dokumentit të ndryshimit të PKS-së.

5. Gjatë hartimit të ndryshimit të Planit Kombëtar Sektorial për projektin TAP, dokumenti duhet të konsultohet me AKPT-në, e cila mbështet procesin, duke verifikuar përputhshmërinë me instrumentet e planifikimit dhe legjislacionin në fuqi.

6. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Ministria e Zhvillimit Urban për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 63, datë 27.1.2016****PËR RIORGANIZIMIN E
OPERATORËVE QË OFROJNË
SHËRBIMIN E FURNIZIMIT ME UJË
TË PIJSHËM, GRUMBULLIMIN,
LARGIMIN DHE TRAJTIMIN E
UJËRAVE TË NDOTURA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 213 e vijues të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të shkronjave “a” e “b”, të nënndarjes I, të pikës 3, të nenit 10, dhe të pikës 3, të nenit 70 e vijues të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës dhe të ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**KREU I****RIORGANIZIMI I SHËRBIMIT TË
FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM,
GRUMBULLIMIT, LARGIMIT DHE
TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA**

1. Riorganizimin e të gjitha shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura në Republikën e Shqipërisë, sipas ndarjes së re administrative-territoriale, në përputhje me ligjin nr. 115/2014, “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.

2. Të gjitha njësitë e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura organizohen si shoqëri aksionare, sipas sistemit me një nivel administrimi dhe funksionojnë në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

3. Bashkive u transferohen aksionet e shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve sh.a., aktuale, në pronësi të ish-njësive të qeverisjes vendore të shkruara, sipas ndarjes së re administrative-territoriale. Bashkitë ndjekin procedurat e kalimit të aksioneve në përputhje me këtë vendim dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

4. Në ato bashki, ku ka njësi të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, të cilat nuk kanë qenë të organizuara në formën e shoqërive aksionare të ujësjellës-kanalizimeve, bashkia, brenda datës 31 dhjetor 2016, është përgjegjëse për inventarizimin fizik, vlerësimin dhe regjistrimin e këtyre njësive të shërbimit në strukturën e aseteve dhe kontabilitetin e ujësjellës-kanalizimeve sh.a., në pronësi të bashkisë, sipas ndarjes administrativo-territoriale.

5. Bashkitë dhe shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve sh.a., janë të detyruara të respektojnë marrëveshjet, detyrimet kontraktore, kontratat e shërbimit, si dhe çdo të drejtë /detyrim që rrjedh prej tyre, të nënshkruara ndërmjet Këshillit të Ministrave, ministrive dhe institucioneve qendrore, shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve dhe ish-njësive të qeverisjes vendore me institucionet financiare ndërkombëtare dhe me shoqëritë kontraktuese.

6. Në rastet kur në dy ose më shumë bashki ekziston vullneti i përbashkët për krijimin e një shoqërie të ujësjellës-kanalizimeve sh.a., të përbashkët, në bazë të nevojave për këtë bashkim e të studimit përkatës, ato do të mbështeten me investime nga qeverisja qendrore.

7. Në rastet kur një shoqëri e ujësjellës-kanalizimeve sh.a., ekzistuese, mbulon me shërbim më shumë se një bashki apo në rastin e parashikuar në pikën 6, të këtij vendimi, organet themeluese të shoqërisë përbëhen nga përfaqësuesit e bashkive përkatëse, pesha e vendimmarrjes së të cilëve është në raport të drejtë me përqindjen e aksioneve që disponon secila bashki. Këshillat bashkiakë përkatës bëjnë miratimin e përqindjeve takuese të aksioneve sipas pikës 3, të këtij vendimi, dhe organet e shoqërisë bëjnë regjistrimin e aksioneve sipas legjislacionit në fuqi.

8. Shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve sh.a., kanë detyrimin të raportojnë pranë ministrisë përgjegjëse për sektorin e furnizimit me ujë e të kanalizimeve dhe prefektit të qarkut për të gjitha të dhënat dhe informacionet sipas formateve e afateve të përcaktuara prej saj. Formatet e dhënies së informacionit miratohen me udhëzime të ministrit të linjës. Gjithashtu, shoqëritë kanë detyrimin për të raportuar për pjesën e tyre të të dhënave që duhet të hidhen në Kadastrën Kombëtare të Burimeve Ujore.



9. Ministria përgjegjëse për sektorin e furnizimit me ujë e të kanalizimeve, në planifikimin e fondeve për investime nga buxheti i shtetit dhe institucionet financiare ndërkombëtare udhëhiqet nga dokumentet strategjike sektoriale të miratuara, si dhe nga performanca e shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve sh.a.

10. Stafi menaxherial dhe operacional i shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve sh.a., i nënshtrohet procesit të trajnimit dhe certifikimit sipas programeve të miratuara nga ministria përgjegjëse për sektorin e furnizimit me ujë e të kanalizimeve.

KREU II

DISPOZITA KALIMTARE E TË FUNDIT

1. Shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve sh.a., organizohen në përputhje me statutin tip, sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Të gjitha bashkitë dhe shoqëritë aksionare ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve, në përputhje me procedurat e parashikuara në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, bëjnë zgjerimin dhe zvogëlimin e kapitalit, sipas rastit, duke shtuar ose duke hequr kapitalet e sistemeve publike të ujësjellës-kanalizimeve që i bashkohen ose që i hiqen.

3. Të gjitha shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve sh.a., brenda 3 (tre) muajve nga riorganizimi, aplikojnë për t’u pajisur me licencë për kategoritë përkatëse të shërbimeve dhe për rishikim të tarifave pranë ERRU-së.

4. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 660, datë 12.9.2007, “Për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjellësve dhe kanalizimeve njësisë të qeverisjes vendore”, nr. 677, datë 3.10.2007, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 642, datë 11.10.2005, të Këshillit të Ministrave “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore”, nr. 678, datë 3.10.2007, “Për një shtesë në vendimin nr. 271, datë 9.5.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e statutit tip të shoqërive anonime, shtetërore”, shfuqizohen.

5. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, Enti Rregullator i Ujit, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve, Agjencia e Zbatimit të Reformës Territoriale, njësitë e qeverisjes vendore, shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LIDHJA NR. 1

STATUTI TIP I SHOQËRIVE AKSIONARE, SHTETËRORE TË UJËSJELLËS- KANALIZIMEVE

STATUT I SHOQËRISË AKSIONARE“ _ ”

Neni 1

Emërtimi dhe selia

1. Shoqëria aksionare ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me zonën e juridiksionit të bashkisë/bashkive _____, aksionarë të saj.

2. Shoqëria e krijuar në këtë mënyrë emërohet Ujësjellës-Kanalizime sh.a.,_____.

3. Selia e shoqërisë është në adresën_____.

Neni 2

Objekti

1. Objekti i shoqërisë brenda territorit të bashkisë së krijuar sipas ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrative-territoriale të njësisë të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, është:

a) Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij;

b) Mirëmbajtja e sistemit/sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm;

c) Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve;

ç) Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura;

d) Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre.

2. Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

3. Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me lejet, autorizimet, licencat sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 3

Kapitali

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është në vlerën ____ lekë. Kapitali i shoqërisë është nënshkruar tërësisht.



2. Kontributet e aksionarit janë kontribute në natyrë, të cilat janë vlerësuar përpara regjistrimit të shoqërisë nga një ekspert i caktuar nga gjykata kompetente, vlerësim i cili është materializuar në një raport vlerësimi që përmban një përshkrim të hollësishëm të kontributeve në natyrë.

Neni 4

Aksionet e shoqërisë

1. Aksionet janë të formës nominative dhe pronësia mbi to është e patjetërsueshme, me përjashtim të rasteve kur e drejta e pronësisë i kalon një organi të qeverisjes vendore.

2. Pronësia mbi aksionet rezulton nga regjistrimi i tyre në emër të titullarit në librin e aksioneve të mbajtura nga ana e shoqërisë.

3. Kapitali i shoqërisë përbëhet nga një kuotë me vlerë _____ lekë dhe zotërohet në masën _____% nga aksionari.

Neni 5

Organet e shoqërisë

1. Organet e shoqërisë së ujësjellës-kanalizimeve sh.a., janë:

- a) Asambleja e Përgjithshme;
- b) Këshilli i Administrimit.

Neni 6

Asambleja e Përgjithshme (AP)

1. Asambleja e Përgjithshme përfaqësohet nga kryetari i bashkisë përkatëse, i cili merr vendime brenda kompetencave të parashikuara nga ligji për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore.

2. Nëse shoqëria aksionare mbulon me shërbim më shumë se një bashki, Asambleja përbëhet nga kryetarët e bashkive përkatëse. Pësia e votës e secilit prej anëtarëve të Asamblesë është në përpjesëtim me përqindjen e aksioneve, sipas ndarjes territoriale-administrative.

3. Asambleja e Përgjithshme mbledhet në selinë e shoqërisë. Ajo thirret nga kryetari i AP-së, Këshilli i Administrimit, administratori i shoqërisë. Ajo mund të thirret, gjithashtu, nga:

- a) eksperti kontabël i autorizuar;
- b) nga një mandatmbajtës, i caktuar nga gjykata, me kërkesën e çdo personi të autorizuar për një rast urgjent;

c) me kërkesë të aksionarit të vetëm të shoqërisë.

4. Asambleja e Përgjithshme thirret në mbledhje të paktën një herë në vit, brenda 6 muajve që pasojnë mbylljen e vitit financiar.

5. Thirrja e mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme bëhet nëpërmjet lajmërimit që botohet në një gazetë të autorizuar për publikimin e njoftimeve ligjore dhe që i dërgohet me anë të një njoftimi me letër rekomande çdo anëtarit të Asamblesë së Përgjithshme me shpenzimet e shoqërisë.

6. Në njoftimin, që duhet t'i shkojë çdo anëtarit të Asamblesë së Përgjithshme apo të njihet prej çdo anëtarit, të paktën 15 ditë përpara mbledhjes së saj, përcaktohen dita, ora dhe vendi ku bëhet mbledhja, natyra e mbledhjes dhe rendi i ditës.

7. Çdo vendim i marrë nga Asambleja e Përgjithshme që thirret në mënyrë të parregullt është absolutisht i pavlefshëm. Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas procedurës së kësaj dispozite, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë anëtarët janë të pranishëm dhe shprehen dakord për të marrë vendime, pavarësisht nga parregullsia.

Neni 7

Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme ka këto kompetenca:

a) Përcakton politikat tregtare të shoqërisë, si dhe miraton planin e biznesit të hartuar nga Këshilli i Administrimit të shoqërisë, i cili duhet të përputhet me kontratën për menaxhimin e shërbimit të furnizimit me ujë e kanalizimeve dhe treguesit të punës, për të cilët është rënë dakord midis palëve kontraktore;

b) Miraton pasqyrat financiare dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë;

c) Miraton projektplanin tarifor që propozohet për miratim në Entin Rregullator të Ujit;

ç) Emëron dhe shkarkon ekspertët kontabël të autorizuar;

d) Vendosi për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;

dh) Çdo kompetencë tjetër që parashikohet të ushtrojë Asambleja e Përgjithshme në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar dhe në statut.



2. Asambleja e Përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e Këshillit të Administrimit dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.

Neni 8

Kryetari dhe sekretari i Asamblesë së Përgjithshme

1. Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme drejtohen nga kryetari i bashkisë përkatëse. Në rast se AP-ja përbëhet nga më shumë se një aksionar, aksionarët zgjedhin kryetarin e AP-së.

2. Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme asistohet nga një sekretar i emëruar nga AP-ja, i cili është përgjegjës për mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve, si dhe për detyrat e tjera asistuese që i ngarkon kryetari i AP-së.

3. Në procesverbalin e çështjeve të shqyrtuara në mbledhjen e AP-së jepen data dhe vendi i mbledhjes, mënyra e thirrjes, rendi i ditës, emrat e drejtuesit e të sekretarit të AP-së, kuorumi i arritur dhe numri i aksioneve me të cilat është votuar, dokumentet dhe raportet e shqyrtuara në mbledhjen e AP-së, një përmbledhje e diskutimeve, teksti i vendimeve të kaluara për votim dhe rezultati i votimit. Procesverbali nënshkruhet nga të gjithë pjesëmarrësit e AP-së në mbledhje, si dhe nga sekretari.

Neni 9

Rendi i ditës i Asamblesë së Përgjithshme

1. Rendi i ditës i mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme përcaktohet nga personi i cili bën lajmërimin.

2. Në rast se mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme nuk realizohet, rendi i ditës i mbledhjes së saj nuk mund të ndryshohet në lajmërimin për mbledhjen e dytë.

Neni 10

Kuorumi dhe marrja e vendimeve

1. Nëse shoqëria zotërohet nga një aksionar, të drejtat dhe detyrimet Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga aksionari i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga aksionari i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;

b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;

c) Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit;

ç) Investimet;

d) Riorganizimin e shoqërisë.

2. Në rastin kur AP-ja ka më shumë se një aksionar, në rastin e çështjeve që vendosen me shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm në mbledhje më shumë se 30% e anëtarëve të saj, me kusht që pjesë e saj të jetë dhe kryetari i Asamblesë së Përgjithshme, me përjashtim të rastit kur AP-ja vendos për shkarkimin e administratorëve e të anëtarëve të Këshillit të Administrimit, ku nuk kërkohet ky kuorum.

3. Kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje të cilat kërkojnë shumicë të cilësuar, sipas pikës 4, të këtij neni, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm në mbledhje më shumë se 50% e anëtarëve të saj, me kusht që pjesë e saj të jetë dhe kryetari i Asamblesë së Përgjithshme.

4. Asambleja e Përgjithshme merr vendim me 3/4 (tre të katërtat) e votave të anëtarëve që marrin pjesë në votim, sipas parashikimeve të pikës 3, të këtij neni, lidhur me:

a) Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;

b) Riorganizimin e shoqërisë.

5. Me përjashtim të rasteve të përcaktuara në ligj dhe në pikën 4, të këtij neni, çdo vendim tjetër i Asamblesë së Përgjithshme merret me shumicën e votave të anëtarëve që marrin pjesë në votim, sipas parashikimeve të pikës 2, të këtij neni.

Neni 11

Këshilli i Administrimit (KA)

1. Këshilli i Administrimit është organi i vetëm që ushtron funksione administrimi dhe mbikëqyrjeje të veprimtarisë së shoqërisë.

2. Kohëzgjatja e funksionit të Këshillit të Administrimit është 3 vjet. Mandati i KA-së ndërpritet në rast konstatimi të mospërmbushjes së objektivave të vendosur në kontratën e performancës midis AP-së dhe anëtarëve të KA-së, sipas legjislacionit në fuqi.



3. Nëse një ose disa vende të anëtarëve të Këshillit të Administrimit mbeten vakant, për shkak vdekjeje, shkarkimi ose dorëheqjeje, zëvendësimi duhet të kryhet jo më vonë se 3 (tre) muaj nga data e mbetjes vakant të vendit. Anëtari i Këshillit të Administrimit i emëruar në zëvendësim të një anëtari tjetër përfundon mandatin e paraardhësit.

4. Anëtarët e Këshillit të Administrimit nuk mund të bëjnë pjesë në më shumë se 1 (një) Këshill Administrimi të shoqërive aksionare që e kanë selinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

5. Këshilli i Administrimit zgjedh ndërmjet anëtarëve të tij një kryetar dhe një zëvendëskryetar, të cilët thërrasin mbledhjen e Këshillit dhe drejtojnë diskutimet. Ata ushtrojnë këtë funksion për të gjithë kohën e mandatit të tyre dhe janë të rizgjedhshëm. Këshilli i Administrimit mund të emërojë një sekretar jashtë anëtarëve të tij dhe i cakton atij dhe pagën, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Në rast mungese të kryetarit, mbledhjet e Këshillit të Administrimit drejtohen nga zëvendëskryetari.

Neni 12

Përbërja e Këshillit të Administrimit

1. Anëtarët e Këshillit Administrimit janë persona fizikë të cilët zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme për një mandat 3-vjeçar dhe mund të rizgjidhen. Ata duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Të jenë me profesion inxhinierë të fushës, ekonomist ose jurist.

- Të kenë të paktën eksperiencë pune jo më pak se 5 (pesë) vjet në fusha të njëjta ose të përafërta me objektin e veprimtarisë së shoqërisë.

Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këtë nen është absolutisht i pavlefshëm.

2. Këshilli Administrimit përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, 1 (një) prej të cilëve është administratori dhe 2 (dy) janë persona të cilët nuk janë të punësuar në shoqëri.

3. Anëtarët e Këshillit të Administrimit në momentin e emërimit lidhin me shoqërinë një kontratë pune, në të cilën janë parashikuar, ndër të tjera, kriteret e qarta performance që pritet të arrijë anëtari i Këshillit të Administrimit në terma vjetorë. Objektivat për performancën (indiktorët) e vendosur në këtë kontratë duhet të miratohen edhe nga ministria e linjës dhe duhet të jenë të matshëm

dhe në përputhje me biznesplanet e shoqërisë.

4. Në rastin e vendeve vakante, që krijohen me vdekjen apo dorëheqjen e një apo disa anëtarëve të Këshillit të Administrimit, kur numri i anëtarëve të këtij këshilli ka zbritur nën minimumin ligjor, administratorët duhet të thërrasin urgjentisht mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme për të plotësuar numrin e anëtarëve të Këshillit të Administrimit.

Neni 13

Kompetencat e Këshillit të Administrimit

1. Këshilli i Administrimit ushtron, njëkohësisht, funksione administrimi e mbikëqyrjeje të veprimtarisë së shoqërisë dhe i jep administratorit autorizimin për kryerjen e veprimeve që nuk mund të kryhen prej tij pa autorizimin e Këshillit të Administrimit.

2. Këshilli i Administrimit ka të drejtë të kryejë në çdo kohë verifikime dhe kontrole që ai i çmon të përshtatshme dhe të njihet me dokumentacionin që e gjykon të nevojshëm për përmbushjen e detyrës së tij.

3. Këshilli i administrimit ka këto të drejta dhe përgjegjësi:

- a) Të japë direktiva për administratorin për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë;

- b) Të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratori;

- c) Të gjykojë paraprakisht biznesplanin e shoqërisë, të paraqitur nga administratori. Ky dokument duhet të miratohet e të nënshkruhet nga të gjithë e anëtarët e Këshillit të Administrimit për t'u paraqitur Asamblesë së Përgjithshme për miratim;

- ç) Të përgatitë, me kërkesë të Asamblesë së Përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;

- d) Të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;

- dh) Të respektojë standardet e kontabilitetit;

- e) Të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;

- ë) Të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecures së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga



administratori. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e Këshillit të Administrimit për t'iu paraqitur Asamblesë së Përgjithshme, së bashku me një raport të Këshillit të Administrimit për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;

f) Të sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur, dhe raporti i auditimit, drejtuar Asamblesë së Përgjithshme, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të Këshillit të Administratorëve. Raporti i Këshillit të Administrimit, përmendur në shkronjën “ë” të kësaj pike, duhet të përmbajë edhe mendimin për raportin e auditimit;

g) Të miratojë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare, të certifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve apo instrumenteve të tjera të borxhit;

gj) Të miratojë paraprakisht biznesplanin e paraqitur nga administratori dhe t'ia paraqesë për miratim përfundimtar Asamblesë së Përgjithshme.

4. Këshilli i Administrimit ka të drejtë t'i propozojë Asamblesë së Përgjithshme:

a) Përcaktimin dhe ndryshimin e programit të veprimtarisë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë të shoqërisë;

b) Treguesit e performancës që duhet të arrijë shoqëria në fund të vitit fiskal, si element bazë i vlerësimit të punës së administratorëve të shoqërisë;

c) Kryerjen e investimeve dhe financimeve për vitin financiar, si dhe masat e tjera që do të kërkonin ndryshimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;

ç) Marrjen e huave afatmesme e afatgjata;

d) Për çdo çështje tjetër që në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, është kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 14

Mbledhja dhe vendimet e Këshillit të Administrimit

1. Këshilli i Administrimit mbledhet jo më pak se një herë në muaj muaj dhe sa herë e kërkon

interesi i shoqërisë aksionare, me thirrjen e kryetarit.

2. Kryetari duhet të thërrasë mbledhjen e Këshillit të Administrimit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita kur administratori ose 2 (dy) prej anëtarëve të Këshillit të Administrimit i paraqesin atij një kërkesë të motivuar për këtë qëllim.

3. Nëse kërkesa mbetet pa përgjigje, atëherë anëtarët kërkuar mund të thërrasin Këshillin e Administrimit duke i përcaktuar rendin e ditës.

4. Njoftimi për thirrjen e mbledhjes bëhet me shkrim jo më vonë se 3 (tre) ditë përpara mbledhjes dhe dërgohet me postë ose në rrugë elektronike.

5. Çdo thirrje për mbledhjen e Këshillit të Administrimit duhet të përmbajë çështjet kryesore të rendit të ditës. Mbledhja e Këshillit të Administrimit zhvillohet në selinë e shoqërisë ose në çdo vend tjetër të treguar në thirrjen e bërë për këtë qëllim.

6. Këshilli i Administrimit mban një regjistër të pjesëmarrjes në mbledhje, i cili nënshkruhet në çdo mbledhje nga anëtarët e Këshillit të pranishëm në atë mbledhje.

7. Vendimet e Këshillit të Administrimit pasqyrohen në procesverbalet e mbajtura gjatë mbledhjes nga sekretari i Këshillit të Administrimit, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Vendimet e Këshillit të Administrimit duhet të nënshkruhen nga anëtarët pjesëmarrës në mbledhje. Kopjet e këtyre procesverbaleve vërtetohen nga kryetari dhe sekretari.

Neni 15

Shkarkimi i anëtarëve të Këshillit të Administrimit

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë KA-në ose një anëtar të saj, duke vërtetuar mospërmbushjen e objektivave të vendosur në kontratën midis palëve, me shumicë të thjeshtë votash.

Neni 16

Përfundimi i mandatit të anëtarëve të Këshillit të Administrimit

Mandati i anëtarëve të Këshillit të Administrimit përfundon në rastet e mëposhtme:

a) Me mbarimin e mandatit të administratorit.



b) Me konstatimin e atyre rrethanave të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e ushtrimit të mandatit të tyre.

Neni 17

Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit të Administrimit

1. Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit të Administrimit do të caktohet nga Asambleja e Përgjithshme, sipas dispozitave përkatëse ligjore apo nënligjore dhe mbulohet nga shoqëria.

2. Shoqëria njeh, gjithashtu, dhe shpenzimet e bëra nga anëtarë të Këshillit të Administrimit, kur këta të fundit dërgohen me shërbim nga vetë Këshilli i Administrimit për probleme të shoqërisë.

Neni 18

Administratori i shoqërisë

1. Administratori i shoqërisë është person fizik, i cili zgjidhet si i tillë për shkak të funksionit në shoqëri, në të kundërt emërimi i tij është i pavlefshëm. Ai kryen administrimin e përditshëm të shoqërisë. Për t'u zgjedhur administrator, personi duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) Të ketë përfunduar studimet e larta universitare dhe të zotërojë diplomë “Master shkencor”, në shkencat inxhinierike, ekonomike, juridike apo në fushën e administrimit të biznesit, sipas profilit që do të emërohet.

b) Të zotërojë certifikatën përkatëse për aftësimin specifik profesional të tij, sipas detyrës që do të ushtrojë, në fushën e menaxhimit të ujësjellës-kanalizimeve e të trajtimit të ujërave të ndotura. Në rast se në momentin e emërimit të tij, nuk ka përfunduar ende procesi i trajnimit dhe i certifikimit të stafit menaxherial dhe operacional të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve, subjekti të paraqesë vërtetim nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën për pamundësinë objektive për pajisjen me këtë certifikatë. Në çdo rast, administratori paraqet certifikatën sapo certifikimi të jetë bërë i mundur. Konstatimi i mospajisjes me certifikatën përkatëse të kualifikimit përbën shkak për shkarkimin e tij.

c) Të ketë eksperiencë pune si drejtues apo administrator në sektorin publik apo privat, si dhe rezultate pozitive të punës, të vërtetuar me referenca nga punëdhënësit e mëparshëm.

3. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me dispozitën e mësipërme është absolutisht i pavlefshëm.

4. Një person nuk mund të emërohet administrator në më shumë se një shoqëri.

5. Administratori emërohet për një periudhë kohe prej 3 (tre) vjetësh, por në bazë kontratash të rinovueshme vjetore. Rinovimi i kontratave midis Asamblesë dhe administratorit do të jetë vjetor në bazë vlerësimesh pozitive të performancës së punës. Numri i mandateve është i pakufizuar.

6. Paga e administratorit caktohet nga Asambleja e Përgjithshme në aktin e emërimit të tij. Asambleja e Përgjithshme propozon shtim të pagës apo shpërblime për administratorin sipas kriterëve të performancës në kontratën e punës së lidhur ndërmjet tij dhe administratorit.

7. Administratori Ekzekutiv ka këto kompetenca:

a) Menaxhon dhe është përgjegjës për aktivitetin e shoqërisë nëpërmjet zbatimit të politikave e të planeve të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme.

b) Harton planbizneset e shoqërisë dhe i paraqet në Këshillin Administrimit.

c) Harton strukturën e organizimit dhe rregulloren e brendshme të veprimtarisë së shoqërisë e cila miratohet nga Këshilli i Administrimit. Struktura e organizimit të shoqërisë duhet të ketë patjetër një drejtori/departament teknik dhe një drejtori/departament tregtar, drejtuesit e të cilave zgjidhen nga administratori (Drejtori i Përgjithshëm) sipas neneve 19 dhe 20, të këtij statuti.

ç) I paraqet Këshillit të Administrimit një raport një herë në muaj për ecurinë e shoqërisë. Brenda tre muajve nga data e mbylljes së ushtrimit financiar, administratori duhet t'i paraqesë Këshillit të Administrimit llogaritë vjetore me qëllim verifikimi dhe kontrolli.

d) Përfaqëson dhe vepron në emër të shoqërisë në marrëdhëniet me palë të treta dhe është përgjegjës për ligjshmërinë e veprimtarisë së saj.

dh) Paraqet çdo vit përpara Asamblesë së Përgjithshme raportin e veprimtarisë së shoqërisë.

e) Raporton përpara Këshillit të Administrimit për zbatimin e politikave tregtare dhe për realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë.



e) Lidh kontrata në emër të shoqërisë pas dhënies së mendimit edhe të dy drejtorëve të tjerë.

f) Siguron bashkëpunimin me institucionet publike dhe personat juridikë vendas apo të huaj në të mirë dhe interes të veprimtarisë së shoqërisë.

g) Nxjerr urdhra dhe udhëzime të brendshëm të detyrueshëm për menaxhimin administrativ e financiar të shoqërisë.

gj) Organizon e bashkërendon punën ndërmjet sektorëve në përbërje funksionale të shoqërisë.

h) Krijon një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë.

i) Kryen regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, dhe ligjeve të tjera në fuqi.

j) I paraqet propozime dhe sugjerime Këshillit të Administrimit, në të mirë dhe interes të veprimtarisë së shoqërisë, sa herë që i kërkohet ose me nismën e vet.

k) Siguron zbatimin e vendimeve të Këshillit të Administrimit.

l) Drejton veprimtarinë e shoqërisë, zgjedh dhe mbikëqyr personelin e saj, përfshirë punësimin, administrimin, kualifikimin e personelit dhe masat disiplinore, në përputhje me ligjin, statutin e shoqërisë dhe rregullat e miratuara nga Këshilli i Administrimit.

Neni 19

Kriteret e përzgjedhjes dhe kompetencat e drejtorit teknik

1. Drejtori teknik zgjidhet nga administratori (Drejtori i Përgjithshëm) sipas kriterëve minimale:

a) Të ketë përfunduar studimet e larta universitare dhe të zotërojë diplomë “Master shkencor”, në shkencat inxhinierike, në degët inxhinieri hidroteknike, mjedisi, ndërtimi, biokimike, mekanike apo disiplina të ngjashme,

b) Të ketë përvojë pune jo më pak se 3 vjet.

Në rastet kur operatori ushtron veprimtari për përpunimin e ujërave për konsum publik apo për përpunimin e ujërave të ndotura, duhet të ketë edhe një drejtues të dytë teknik, të kualifikuar me diplomë universitare në degët inxhinieri hidroteknike, mjedisi, ndërtimi, biokimike, mekanike apo disiplina të ngjashme.

c) Të zotërojë certifikatën përkatëse për aftësimin specifik profesional të tij, sipas detyrës që do të ushtrojë, në fushën e menaxhimit të ujësjellës-kanalizimeve-trajtimin e ujërave të ndotura. Në rast se në momentin e emërimit të tij nuk ka përfunduar ende procesi i trajnimit dhe certifikimit të stafit menaxherial dhe operacional të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve, subjekti të paraqesë vërtetim nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën për pamundësinë objektive për pajisjen me këtë certifikatë. Në çdo rast, administratori paraqet certifikatën sapo certifikimi të jetë bërë i mundur. Konstatimi i mospajisjes me certifikatën përkatëse të kualifikimit përbën shkak për shkarkimin e tij.

2. Drejtori teknik ka këto kompetenca:

a) Bën studimin dhe hartimin e projekteve të nevojshme për furnizimin me ujë të konsumatorëve të veçantë ose zonave të banuara.

b) Bën përditësimin e rrjetit të furnizimit me ujë e të kanalizimeve të ujërave të ndotura.

c) Është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe kontrollin e rrjetit shpërndarës.

ç) Administron dhe mirëmban gjithë rrjetin e tubacioneve, kolektorët kryesorë, pusetat e shkarkimit të ujërave të ndotura dhe pajisjet që shërbejnë për largimin e ujërave të ndotura që vijnë kryesisht nga banesat (ujëra të ndotura dhe industriale).

d) Është përgjegjës për sigurimin e furnizimit me ujë të pijshëm sasior dhe cilësor në zonën e shërbimit sipas standardeve në fuqi dhe garantimin e një sistemi teknikisht të përshtatshëm për furnizimin me ujë që nga burimet deri te konsumatori.

dh) Garanton largimin efikas të ujërave të ndotura me anë të një sistemi të përshtatshëm të rrjetit të kanalizimeve dhe trajtimin e tij në impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura.

e) Çdo detyrë të caktuar në kontratën e punës me Drejtorin e Përgjithshëm

Neni 20

Kriteret e përzgjedhjes dhe kompetencat e drejtorit tregtar

1. Drejtori tregtar zgjidhet nga administratori (Drejtori i Përgjithshëm) sipas kriterëve minimale:

a) Të ketë përfunduar studimet e larta universitare dhe të zotërojë diplomë “Master



shkencor”, në shkencat ekonomike, në degët financë/administrim biznesi.

b) Të zotërojnë certifikata përkatëse për aftësimin specifik profesional të tij, sipas detyrës që do të ushtrojnë.

2. Drejtori tregtar ka këto kompetenca:

a) Siguron mbarëvajtjen dhe zbatimin e procedurave ligjore për të gjithë veprimtarinë ekonomike-financiare të shoqërisë.

b) Siguron zbatimin e praktikave e të procedurave ligjore dhe nënligjore të cilat mbrojnë asetet e shoqërisë dhe administron burimet financiare të saj.

c) Harton planbuxhetin për vitin pasardhës dhe planet financiare strategjike për shoqërinë, të cilat i paraqet për miratim pranë administratorit ekzekutiv.

ç) Është përgjegjës dhe nënshkruan pasqyrat financiare vjetore individuale dhe të konsoliduara, si dhe raportin e administrimit, dokumente të cilat ia paraqet për miratim paraprak administratorit ekzekutiv. Administratori ekzekutiv i paraqet Këshillit të Administrimit për miratim të gjitha pasqyrat financiare vjetore, raportin e administrimit, si dhe propozimet për caktimin e fitimit.

d) Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë.

dh) Ushtron kontrole periodike mbi veprimtarinë ekonomike-financiare të ndjekur nga specialistët përkatës.

e) Garanton ruajtjen e standardeve të kontrollit të brendshëm financiar dhe zbatimin e standardeve të kontrollit financiar të specifikuar nga Ministria e Financave.

ë) Siguron zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë.

f) Siguron zbatimin e sistemit financiar dhe të faturim/arkëtimit të shoqërisë.

g) Çdo detyrë të caktuar në kontratën e punës me drejtorin e Përgjithshëm.

Neni 21

Detyrimi i besnikërisë

1. Përveç sa parashikohet në dispozitat e këtij statuti, administratorët detyrohen:

a) Të kryejë detyrat e tyre, të përcaktuara në ligj ose në statut, në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë;

b) Të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut, vetëm për arritjen e qëllimeve, të përcaktuara në këto dispozita;

c) Të vlerësojnë në mënyrë të përshtatshme çështjet për të cilat merret vendim;

ç) Të parandalojnë dhe të mënjanojnë rastet e konfliktit, të pranishme apo të mundshme, të interesave personale me ato të shoqërisë;

d) Të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim gjatë kryerjes së detyrave të tyre, me përjashtim të rasteve kur veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim, në bazë të hetimit e vlerësimit të mjaftueshëm të informacioneve dhe lidhet, në mënyrë të arsyeshme, me qëllimet e shoqërisë tregtare.

3. Administratorët, që veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet e kujdesit, të përmendura në pikat 1 e 2, të këtij neni, janë të detyruar t'i shpërblejnë shoqërisë dëmet që rrjedhin nga shkeljet, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara.

Neni 22

Shkarkimi i administratorit

1. Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin me shumicë të thjeshtë votash në rast të konstatimit të mospërbushjes së objektivave të kontratës midis palëve.

2. Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë shkarkimin e administratorit brenda 15 ditëve nga data e marrjes së njoftimit nga një institucion shtetëror për shkarkimin e tij, si rezultat i një detyrimi ligjor/zyrtar.

Neni 23

Përfundimi i mandatit të administratorit

Mandati i administratorit të shoqërisë përfundon me konstatimin e atyre rrethanave të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e ushtrimit të mandatit të tij.

Neni 24

Ekspertët kontabël të autorizuar

Kontrolli i shoqërisë ushtrohet nga ekspertë kontabël të autorizuar, të cilët emërohen nga



Asambleja e Përgjithshme dhe kryejnë misionin e tyre në pajtim me ligjin.

Neni 25

Ushtrimi kontabël

Ushtrimi kontabël fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti.

Neni 26

Inventari - llogaritë vjetore

1. Mbajtja e kontabilitetit dhe paraqitja e pasqyrave financiare vjetore bëhet në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar.

2. Në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar, shoqëria i harton pasqyrat financiare vjetore në bazë të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe raportimit financiar.

3. Administratori përgatit, në datën e pasqyrave financiare, raportin e administrimit për gjendjen dhe performancën e shoqërisë gjatë ushtrimit kontabël.

Neni 27

Rezultati i ushtrimit dhe përcaktimi i fitimit

1. Fitimi i tatueshëm përcaktohet sipas dispozitave të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

2. Nga fitimi pas tatimit, i realizuar gjatë vitit financiar paraardhës, duke zbritur shpenzimet, shoqëria duhet të kalojë në rezervën ligjore, të paktën 5 për qind të kësaj vlere, derisa kjo rezervë të jetë e barabartë me 10 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

3. Fitimet e akumuluar nga shoqëria, pas arritjes së rezervës 10 për qind, vlere e të cilave e kalon nevojën për investime dhe zhvillimin e shoqërisë, do t’i kalojnë dhe do të përdoren nga Bashkia. Fitimet e akumuluar brenda këtij kufiri do të përdoren nga shoqëria sipas nevojave të saj për investime kapitale.

Neni 28

Procedura e bashkimit të shoqërisë me operatorë të tjerë

Shoqëria aksionare mund të bashkohet me operatorë të tjerë vetëm në rastet kur nga ana e shoqërive të plotësohen kushtet e mëposhtme:

- a) Të jetë të licencuar nga Enti Rregullator i Ujit.
- b) Të ketë vlerësuar dhe përditësuar inventarin e aseteve e të likuiditeteve të tyre.
- c) Të jetë miratuar me vendim përkatës të Këshillit Bashkiak.

Neni 29

Likuidimi i shoqërisë

Likuidimi i shoqërisë të bëhet sipas mënyrës dhe formës të përcaktuar me ligj.

Neni 30

Dispozita të kalimtare

Për sa nuk është parashikuar në statut, rregullimi i modaliteteve të tjera që lidhen me funksionimin e shoqërisë të bëhet sipas dispozitave të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

VENDIM

Nr. 64, datë 27.1.2016

PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT TË TË RINJVE QË KANË FITUAR STATUSIN E JETIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4 e 8, të ligjit nr. 7995, datë 20.9.1995, “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfitues të këtij programi janë punëkërkuar të rinj, nën moshën 30 vjeç, të cilët kanë statusin e jetimit. Punëkërkuar do të përfitojnë formim nëpërmjet punës dhe punësim. Zyra përkatëse e punësimit financon punëdhënësin:

a) Në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj për trajnimin nëpërmjet punës, për çdo person, për një periudhë 3-mujore;

b) Për çdo punëkërkuar të papunë të përfshirë në program, me një pagesë pjesëmarrjeje në kurs, në masën 100 për qind të pagesë minimale në shkallë vendi, për të gjithë kohëzgjatjen e trajnimit. Zyra përkatëse e punësimit kryen edhe derdhjen e kontributit për sigurimin nga aksidentet në punë, në masën 0.3 për qind të pagesë minimale, i cili derdhet në degën përkatëse;



c) Për çdo punëkërkues të papunë me një financim mujor në masën 100 për qind të pagës minimale në shkallë vendi për 9 muaj dhe në masën 50 për qind të pagës minimale në shkallë vendi, për çdo person, për 6-mujorin pasardhës, me kusht që kohëzgjatja e kontratës së punës të mos jetë më e shkurtër se 21 muaj.

ç) Me një financim mujor, në masën 100 për qind të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, për një periudhë 15-mujore nga data e nënshkrimit të kontratës së punës. Ky financim bëhet nga zyra e punësimit, sipas procedurave përkatëse.

2. Skema të fillojë të zbatohet në vitin 2016 dhe kohëzgjatja e saj të jetë 5 (pesë) vjet.

3. Punëdhënësit, persona juridikë apo fizikë, kanë të drejtë të kërkojnë përfshirjen në program deri në 50 për qind të numrit mesatar të të siguarve në tre muajt e fundit.

Punëdhënësit e rinj, persona juridikë apo fizikë, kanë të drejtë të kërkojnë përfshirjen në program deri 40% të numrit të punonjësve të punësuar.

4. Punëdhënësit, që aplikojnë për këtë program, duhet të kenë një trajnues për deri 15 kursantë.

5. Për të përfutur nga ky program, punëdhënësi duhet të paraqesë pranë zyrës përkatëse të punësimit, ku ai zhvillon veprimtarinë, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Ekstraktin e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrimin, si person juridik apo fizik;

b) Numrin e identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT-in);

c) Vërtetimin për shlyerjen e kontributeve për sigurimet shoqërore e shëndetësore, që lëshohen nga organi tatimor përkatës, për aq kohë sa ushtrojnë veprimtarinë, por jo më shumë se për një periudhë kohore njëvjeçare, nga çasti i aplikimit;

ç) Numrin e llogarisë bankare;

d) Vërtetimin nga dega e tatim-taksave, ku personi juridik ushtron veprimtarinë, për shlyerjen e detyrimeve tatimore për aq kohë sa kryen veprimtarinë, por jo më shumë se për një periudhë kohore njëvjeçare nga çasti i aplikimit. Për personat juridikë apo fizikë, të cilët kanë detyrime ndaj organeve tatimore, por vërtetojnë se në momentin e aplikimit në këtë program:

i) kanë lidhur marrëveshjet përkatëse për shlyerjen e këtyre detyrimeve dhe janë të rregullt në shlyerjen e tyre;

ii) kanë shlyer detyrimet, por kanë ende pa paguar gjobot;

iii) kanë shlyer detyrimet ose kanë vendosur garanci bankare për shumën e plotë të detyrimit, në përputhje me nenin 107, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe janë në proces të apelimit administrativ dhe në procese gjyqësore me organet tatimore.

Këta persona duhet të jenë të pajisur me vërtetimet e lëshuara nga organet tatimore, si dhe me dokumentet përkatëse të pagesës së detyrimeve.

dh) Buxhetin analitik të trajnimit;

e) Informacion për:

i) numrin e fuqisë punëtore;

ii) listën e të siguarve;

iii) nivelin e pagës së dhënë për çdo person;

iv) profesionin, për të cilin do të trajnohen punëkërkuesit e papunë;

v) dobinë social-ekonomike, që do të sjellë aplikimi i këtij programi në zonën përkatëse, mbështetur në mundësitë reale, kapacitetet e lira që ofron subjekti, kushtet e punës e të trajnimit, në përputhje me sipërfaqen, makineritë, pajisjet etj.;

vi) akte të inspektimit në punë, të kryera nga Inspektorati Shtetëror i Punës.

6. Punëdhënësi, në bashkëpunim me zyrën përkatëse të punësimit dhe në mbështetje të të dhënave të dokumentacionit, të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi, plotëson formularin përkatës, sipas modelit të miratuar nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

7. Punëdhënësit mund të aplikojnë për programin në mënyrë elektronike apo pranë zyrave të punësimit.

8. Zyra përkatëse e punësimit i paraqet këshillit vendor trepalësh, të ngritur pranë saj, projektet që kërkojnë të zbatohen aty ku ajo ushtron veprimtarinë. Këshilli vendor trepalësh shqyrton dhe vlerëson dobinë social-ekonomike të projekteve të paraqitura dhe i miraton ato në parim.

9. Pasi projektet të jenë miratuar, në parim, në këshillin vendor trepalësh, ato dërgohen për miratim nga zyra përkatëse e punësimit, si më poshtë vijon:

a) Zyra vendore e punësimit, sipas rastit, ia dërgon Zyrës Qendrore të Punësimit ose Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit;



b) Zyra rajonale e Punësimit miraton projektet, kur aplikuesit janë persona fizikë;

c) Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit miraton projektet, kur aplikuesit janë persona juridikë.

10. Për zbatimin e pikës 8, të këtij vendimi, në zyrat rajonale të punësimit dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit ngrihen komisionet e miratimit të projekteve, me jo më pak se 5 persona.

11. Mënyra e organizimit, vlerësimit të projekteve dhe e funksionimit të punës, si dhe përbërja e komisioneve përcaktohen me rregullore të këshillit administrativ trepalësh të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

12. Komisionet e miratimit të projekteve në zyrën rajonale të punësimit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, pas hedhjes në sistemin përkatës, vendosin miratimin ose jo të projektit brenda 10 (dhjetë) ditëve pune.

13. Për projektet e miratuara, zyra përkatëse e punësimit, në bashkëpunim me punëdhënësin, plotësojnë listën e punëkërkuesve të papunë, që do të përfshihen në program, të cilët duhet të jenë të regjistruar në zyrat e punësimit.

14. Personat punëkërkues të papunë, që kundërshtojnë ofertën e zyrës përkatëse të punësimit për pjesëmarrjen në formim, si më sipër, hiqen nga lista e punëkërkuesve të papunë.

15. Ndërmjet Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe punëdhënësit nënshkruhet një kontratë, ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet, në përputhje me programin për secilën palë.

16. Kontratat lidhen vetëm për vitin buxhetor, për të cilin është miratuar projekti.

17. Për vazhdimin e projektit në vitin pasardhës do të lidhet një kontratë shtesë, në përputhje me fondet e miratuara atë vit.

18. Punëdhënësit dhe punëmarrësit nënshkruajnë një kontratë individuale për mësimin e profesionit, sipas përcaktimeve të bëra në Kodin e Punës dhe në këtë vendim.

19. Punëdhënësi, në rastet e largimit të punëkërkuesve të papunë që trajnohen, mund të bëjë zëvendësimin e tyre, brenda dy muajve të parë të zbatimit të programit.

20. Ky zëvendësim bëhet nga zyra përkatëse e punësimit, pas njoftimit nga punëdhënësi.

21. Në zbatim të pikës 1 të këtij vendimi, lidhet kontrata individuale, ndërmjet punëdhënësit dhe punëkërkuesit, si punëmarrës, ku përcaktohen të drejtat e detyrimet e palëve deri në përfundim të programit.

22. Një kopje e kontratës së punës depozitohet në zyrën përkatëse të punësimit, e cila ndjek zbatimin e kontratës deri në përfundim të projektit.

23. Nëse punëdhënësi nuk respekton kushtin e punësimit pas formimit në punë, atij i hiqet e drejta për të riaplikuar në projekte të nxitjes së punësimit.

24. Nëse punëdhënësi, në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkaqe të arsyeshme, bën zgjidhje të kontratës së punës për punëmarrësin e trajnuar, është i detyruar ta kthejë të gjithë financimin e marrë për punëkërkuesin e punësuar, që nga data e parë e dhënies së tij, së bashku me interesat e llogaritura sipas normës bazë të interesit të Bankës së Shqipërisë.

25. Kontratat tip, sipas përcaktimeve të dhëna në pikat 14, 15 e 17, të këtij vendimi, hartohen nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga zyrat përkatëse të punësimit.

26. Zyra përkatëse e punësimit harton dhe dërgon, çdo muaj, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, informacion për zbatimin e projekteve, personat e trajnuar, përfituesit e programeve të mbështetjes me të ardhura, punëkërkuesit e papunë etj.

27. Shërbimi Kombëtar i Punësimit analizon efektshmërinë e programit dhe përgatit raporte vjetore, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, të cilat ia paraqet Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Drejtorisë së Ndihmës Shtetërore, në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

28. Shërbimi Kombëtar i Punësimit i ruan të dhënat për skemën deri në 10 (dhjetë) vjet pas dhënies së fundit të ndihmës individuale.

29. Programi vlerësohet në vitin pasardhës nga ekspertë ose organizata të pavarura me përvojë në këtë fushë dhe që kanë njohuri për tregun e punës sipas procedurave përkatëse.



30. Kostoja dhe vlerësimi i këtij programi përballohen nga fondet vjetore të buxhetit të shtetit, zëri “Nxitja e punësimit”, miratuar për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

31. Ngarkohet Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 588 lekë